

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **K.K. SKENDERAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

<b>Nr i Prokurimit</b>	<b>643-24-2330-5-5-8</b>
<b>Nr i brendshëm</b>	

Sa i përket tenderit për

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj **Botek shpk**  
NUI **810356081**  
Adresa **Rr. Agim Ramadani, objekti C, nr 517**  
Vendi **Prishtinë**  
Kodi postar **10000**  
Numri Telefonit **049/766677**  
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj **Leonida Tërnavë**  
Adresa elektronike **leonida.ternava@bo-tek.com**  
Data e parashtrimit të kërkesës **07.05.2024**

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-i  
Adresa elektronike t

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Ftesa për ofertim, datë 14.03.2024
- Afati i fundit për dorëzim të ofertave, datë 25.03.2024, ora 14:00.
- Hapja e ofertave, datë 25.03.2024
- Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, datë 02.05.2024
- Kërkesa për qasje në dokumente, datë 02.05.2024
- Qasja në dokumente, datë 03.05.2024

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

#### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

*Neni 7 i LPP Nr. 04/L-042 Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi*

*Neni 28 i LPP Nr. 04/L-042 Specifikimet teknike*

*Neni 59 i LPP Nr. 04/L-042 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

*Pika 19 e RRPP-së Specifikimet Teknike*

*Pika 40 e RRPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Përmes kësaj Kërkesë për Rishqyrtim atakojmë vendimin tuaj të datës 02.05.2024 për dhënie të kontratës për OE Infinitt shpk.

Me datë 03.05.2024, ne na është lejuar qasja në dokumentet e dorëzuara nga OE i propozuar për kontratë.

Kërkesën tonë për Rishqyrtim e bazojmë në tri arsye të faktuara, të bazuara në ofertën e OE Infinitt shpk, sipas të cilave ky OE duhej të eliminohej dhe të shpallej i papërgjegjshëm:

### **Arsyeja 1:**

Nga FPO – Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme, ju keni kërkuar në pozicionin 1: Brand Name Monitor – Modeli I dhe në pozicionin 2: Brand Name Monitor - Modeli II, me specifikën: **Audio: Po**

### ***Prova 1 - FPO - Aneksi 1 - Brand Name Monitor - Model I dhe Brand Name Monitor – Model II***

OE Infinitt shpk, bazuar në broshurat e dorëzuara me ofertën e tyre, ka ofertuar për pozicionin 1 - monitorin HP P22 G5 FHD Monitor dhe për pozicionin 2 - HP V24i FHD Monitor.

### ***Prova 2 – Infinitt shpk - Broshurat e Monitorave***

Këta dy monitora, pavarësisht që OE deklaroi në dokumentin “Deklaratë për spec teknike” se: Me ane të kësaj letre deklarojme/garantojme se IT paisjet të cilat kemi ofertuar për projektin e lartecelës plotësojnë të gjitha kërkesat e AK si në ANEKS 1 të dosjes së tenderit dhe në paramasë., siç shihet në broshurat e tyre përkatëse nuk përmbushin specifikën **Audio: Po** të kërkuar në FPO, pasi që asnjëri nga këta monitora nuk përmban asnjë port për Audio e as Speakers të integruar e as nuk ka asnjë specifikë tjetër që përmbush këtë kërkesë.

## Arsyeja 2:

Nga FPO – Aneksi 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme, ju keni kërkuar në pozicionin 3: Brend Name PC - Modeli II dhe në pozicionin 5: Brend Name PC - Modeli I, me specifikën: Kartela grafike: **Minimum dy porte: HDMI DP**

### ***Prova 3 - FPO - Aneksi 1 - Brend Name PC - Modeli II dhe Brend Name PC - Modeli I***

OE Infinitt shpk, bazuar në broshurat e dorëzuara me ofertën e tyre, ka ofertuar për pozicionin 3 – HP Pro Tower 290 G9 Desktop PC dhe për pozicionin 5: PC HP Pro Tower 290 G9 Desktop PC.

### ***Prova 4 - Infinitt shpk - Broshurat e PC-ve***

Ky PC, pavarësisht që OE deklaron në dokumentin “Deklaratë per spec teknike” se: Me ane te kesaj letre deklarojme/garantojme se IT paisjet te cilat kemi ofertuar per projektin e lartecekur plotesojne te gjitha kerkesat e AK si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit dhe ne paramase., siç shihet në broshurat e tyre përkatëse nuk përmbush specifikën **Kartela grafike: Minimum dy porte: HDMI DP** të kërkuar në FPO, pasi që ky PC nuk përmban asnjë port DP, siç kërkohet në FPO.

Andaj, në bazë të Rregullores së Prokurimit Publik, neni 19 - Specifikimet Teknike, **pika 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet ti përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm**, oferta e këtij OE nuk është e përgjegjshme, pasi nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga ju si AK dhe si e tillë duhet të eliminohet.

***(Prova 5 - RrPP - Neni 19 - pika 19.11)***

Për raste të ngjashme kemi pasur dhe vendime të AK (MBPZhR, Arkivi i Kosovës, IBCM), të cilat po i bashkangjesim si prova në këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

***(Prova 6 – Vendimi i AK MBPZhR në KpR tonë***

***Prova 7 – Vendimi i AK Arkivi i Kosovës në KpR tonë***

***Prova 8 – Vendimi i AK IBCM në KpR tonë)***

## Arsyeja 3:

Në dokumentet e OE Infinitt shpk, i cili është shpallur fitues nga ana juaj, kemi vërejtur që mungon dokumenti kyq për vlerësim të ofertës, e që është deklarata mbi specifikimet teknike.

Nga **FPO – Neni IV.6) Formulari i Tenderit dhe numri i ekzemplareve të Tenderit dhe Lista e dokumenteve të kërkuara**, shkruan citat: *Tenderi do të përbëhet nga dokumentet e plotësuar dhe të nënshkruara në vijim:*

*b) Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së.*

**(Prova 9 – FPO – Neni IV.6)**

OE Infinit shpk me ofertën e tyre ka dorëzuar vetëm dokumentet “Deklaratë per spec teknike” ku deklarohet citat: “Me ane te kesaj letre deklarohet/garantohet se IT paisjet te cilat kemi ofertuar per projektin e lartecelur plotesojne te gjitha kerkesat e AK si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit dhe ne paramase” dhe dokumentin “Aneks 2 dhe specifikimet teknike”, në të cilin ka vendosur Aneksin 1 që e ka marrë nga FPO dhe vetëm e ka nënshkruar dhe vulosur, por nuk ka deklaruar specifikimet e produkteve të cilat i oferton.

**(Prova 10 - Infinit shpk - Deklarate spec teknike dhe Aneks 2 dhe specifikimet teknike)**

OE Infinit shpk ka dorëzuar broshurat e produkteve të ofertuara, por, në broshura ekzistojnë disa opsione të ndryshme për të njëjtin specifikim, si psh. për procesor, memorie, storage, kartelë grafike etj dhe OE nuk ka nënvizuar/hijeziuar opsionet me të cilat oferton dhe të cilat përmbushin kërkesat në Aneksin 1 – Specifikimet teknike të detyrueshme.

Sipas këtyre dokumenteve të dorëzuara, natyrshëm lind pyetja se si keni pasur mundësi ju si Autoritet Kontraktues të bëni vlerësimin e drejtë të ofertave, kur nuk keni pasur dokument të qartë se çfarë ky OE ka ofertuar?

Në Marrëveshjen Publike Kornizë (bazë për këtë Ftesë për Ofertim), shprehimisht kërkohet që: *për secilin produkt duhet të specifikoni emrin e modelit që ofertoni. Në kolonën e parë të secilit produkt tek – Prodhuesi – Brand Name, duhet të shkruani emrin e modelit duke përfshirë emrin e prodhuesit dhe emrin e saktë të modelit të cilin e ofroni.*

Pikërisht i njëjti dokument është kërkuar edhe nga ju si AK në FPO – neni IV.6) Formulari i tenderit dhe numri i ekzemplarëve të Tenderit dhe Lista e Dokumenteve të kërkuara, ku shkruan, citat:

b. Deklarata mbi Specifikimet Teknike të objektit të ofruar të kontratës, që korrespondon me ato të përmendura në Aneksin 1 të FPO-së.

Sipas Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, pika 10 – Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve – *Nëse Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund të dorëzoj specifikimin teknik të një produkti të caktuar p.sh. peme/ përime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklarohet se mallrat do të jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar), atëherë AK duhet të veprohet duke Refuzuar tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm, bazuar në nenin 28 të LPP.*

**(Prova 11 - Udhëzuesi për Prokurimin Publik)**

Për rast të ngjashëm kemi pasur dhe vendim të AK (KK Fushë Kosovë), të cilin po e bashkangjesim si provë në këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

**(Prova 12 – Vendimi i AK KK Fushë Kosovë në KpR tonë)**

AK, duke shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm, ka shkelur LPP,- Neni 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, pika 4 dhe RrPP - Neni 40 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, pika 6.

Prandaj, bazuar në të gjitha faktet e paraqitura më sipër, kërkojmë nga ju që:

- 1. Të aprovoni Kërkesën tonë për Rishqyrtim si të bazuar**
- 2. Të anuloni Njoftimin mbi Vendimin tuaj të datës 02.05.2024.**
- 3. Të respektoni LPP, RrPP dhe UPP duke eliminuar dhe shpallur të papërgjegjshëm OE Infinitit shpk.**
- 4. Lëndën ta ktheni në rivlerësim.**

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Humbja e fitimit të parashikuar nga kontrata.**

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*